

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-043/13

**Prishtinë,
3 Qershor 2015**

Në çështjen juridike të

M. H.

Skenderaj

Pala ankuese

kundër.

S.V.

Beograd/Serbi

Paraqitësi i kërkesës 1

dhe

D. B. M.

Lazareviac/Serbi

Paraqitësit e kërkesës 2

Paraqitësit e përgjigjes në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme i përbërë nga gjyqtarët, Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Éillem Brouëer, anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/76/2010 (lënda e regjistruar në AKP

me numrin KPA08225) i datës 16 qershor 2010, KPCC/D/A/119/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA44097) i datës 7 shtator 2011 dhe KPCC/D/A/126/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrat KPA08233, KPA08229, KPA08227, KPA08226) të datës 26 tetor 2011 pas shqyrtimit të mbajtur më 3 qershor 2015, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Ankesat e M. H., të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-043/2013, GSK-KPA-A-044/2013, GSK-KPA-A-045/13 dhe GSK-KPA-A-046/13, GSK-KPA-A-047/13 dhe GSK-KPA-A-A048/12 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-043/2013.
2. Hidhen poshtë si të papranueshme ankesat e M. H. kundër vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/76/2010 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA08225) të datës 16 qershor 2010, KPCC/D/A/119/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA44097) të datës 7 shtator 2011 dhe KPCC/D/A/126/2011 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA08226, KPA08227, KPA08229 dhe KPA08233), për shkak se ankesat janë të pasafatshme.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 7 qershor 2007, S. V. (në tekstin e mëtejshëm: paraqitësja e kërkesës 1), djali i R. M., ka paraqitur në kërkesë (e regjistruar me numrin KPA 44097) pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar të drejtën e ri-posedimit, ndërsa më 26 dhjetor 2006, D. B. M. (në tekstin e mëtejshëm: paraqitësi i kërkesës 2) djali i B., O. M. ka paraqitur pesë (5) kërkesa (të regjistruara në lëndën nr. KPA08225, KPA08226, KPA08227, KPA08229, KPA08233), pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar të drejtën e ri-posedimit.
2. Në kërkesa thuhet se posedimi ndaj pronave të kërkuara ishin humbur për shkak të rrethanave që ndërliidhen me konfliktin e armatosur që ndodhi në Kosovë në vitet 1998/99, duke cekur 12 qershorin e vitit 1999 si datën e humbjes.
3. Për t'i mbështetur kërkesat e tyre, paraqitësja e kërkesës 1 dhe paraqitësi i kërkesës 2 dorëzuan në AKP këto dokumente:

- Çertifikatën e martesës nr. ... të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil, Komuna e Zemunit, më 25 mars 1991 që tregon se babai i S. M. është R. M.
 - Çertifikatën e vdekjes të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil, Komuna e Zemunit, që tregon se R. M. ka vdekur më 14 gusht 1998 në Zemun.
 - Fletën Poseduese nr. 51 të lëshuar nga Institucioni Gjeodezik i Serbisë, Qendra për Kadastër dhe Pronë të Paluajtshme në Skenderaj më 26 maj 2003, ku pronat e kërkuara (lënda nr. KPA44097) ishin të regjistruara në emër të R. R. M.
 - Vendimin plotësues të trashëgimisë Posl.Br.II-O.926/04 të datës 19 korrik 2004 të lëshuar nga Gjykata e katërt Komunale e Beogradit. Bazuar në këtë Vendim, gjykata konstaton trashëgiminë shtesë të të ndjerit, R. M., që përbëhet nga prona e paluajtshme e shënuar në Fletën Poseduese nr.51, Komuna e Skenderajit, Zona Kadastrale Kotore. Trashëgimtare e vetme për trashëgiminë shtesë ishte shpallur S. V. (e bija e R. M.).
 - Fletën Poseduese nr.50 të lëshuar nga Institucioni Gjeodezik i Serbisë, Qendra për Kadastër dhe Pronë të Paluajtshme në Skenderaj më 17 gusht 2005, ku pronat e kërkuara (lënda nr. KPA08225, KPA08226, KPA08227, KPA08229, KPA08233) ishin regjistruar në emër të B. O. M.
 - Vendim i plotëfuqishëm Trashëgimie, O.Br.374/05 të datës 28 tetor 2005 të lëshuar nga Gjykata Komunale Lazarevac. Sipas vendimit, D. dhe Z. M. shpallen trashëgimtarë të pronës së shënuar në Fletën Poseduese nr. 51 dhe atë secili nga ½ e pjesës ideale të pronës.
 - Çertifikatën e vdekjes të datës 21 shkurt 2008 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës Lazarevac që tregon se B. M. ka vdekur më 5 korrik 2005 në Lazarevac.
4. Sipas Fletës Poseduese nr. 50 të datës 26 maj 2003 dhe Fletës Poseduese nr.51 të datës 17 gusht 2005 të Qendrës për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë të Komunës së Skenderajit, ngastrat kadastrale të kërkuara nga paraqitësja e kërkesës 1 dhe paraqitësi i kërkesës 2 (në tekstin e mëtejme të gjitha: pronat e kërkuara), që ndodhen në zonën kadastrale të Kotorit, janë të regjistruara si në vijim

Numri i ankesës dhe lënda e AKP-së	Të dhënat rreth ngastrës së kërkuar
------------------------------------	-------------------------------------

GSK-KPA-A-043/13 (KPA44097)	Fleta Poseduese nr.51, ngastra nr.133, te vendi i quajtur “Rog – Isenov lug”, livadh i klasit 4 me sipërfaqe prej00.19.42 ha Fleta Poseduese nr.51, ngastra nr.134, te vendi i quajtur “Rog – Isenov lug”, pyll i klasit 4 me sipërfaqe prej00.31.10 ha Fleta Poseduese nr.51, ngastra nr.135, te vendi i quajtur “Rodevic-ara e malit”, livadh i klasit 6 me sipërfaqe prej00.43.95 ha Fleta Poseduese nr.51, ngastra nr.136, te vendi i quajtur “Rodevic-ara e malit”, livadh i klasit 6 me sipërfaqe prej00.12.50 ha
GSK-KPA-A- 044/13 (KPA08233)	Fleta Poseduese nr.50, ngastra nr. 503, te vendi i quajtur “Kodra vojs”, livadh i klasit 5 me sipërfaqe prej00.02.60 ha
GSK-KPA-A-045/13 (KPA08229)	Fleta Poseduese nr.50, ngastra nr. 207 te vendi i quajtur “Rodevci-Lugi i Duceve” , tokë e kultivuar e klasit 7 me sipërfaqe prej 00.91.74 ha dhe ngastra nr.208, “Rodevci-Lugi i Duceve”, livadh i klasit 6 me sipërfaqe prej 00.12.45 ha
GSK-KPA-A-046/13 (KPA08227)	Fleta Poseduese nr.50, ngastra nr. 137 te vendi i quajtur “Rog-Lugu Gat” , livadh i klasit 6 me sipërfaqe prej00.16.05 ha
GSK-KPA-A-047/13 (KPA08226)	Fleta Poseduese nr.50, ngastra nr. 128 te vendi i quajtur “Rog-Lugu Gat” , livadh i klasit 6 me sipërfaqe prej 00.14.50 ha dhe ngastra nr. 129 te vendi i quajtur “Rog-Lugu Gat” , pemishte e klasit 4 me sipërfaqe prej00.03.40 ha
GSK-KPA-A-048/13 (KPA08225)	Fleta Poseduese nr.50, ngastra nr. 126 te vendi i quajtur “Rog-Lugu Gat” , livadh i klasit 6 me sipërfaqe prej 01.23.60 ha dhe ngastra nr. 127 te vendi i quajtur “Rog-Lugu Gat” , pyll i klasit 4 me sipërfaqe prej02.16.75 ha

5. Identifikimi fizik i kërkesës (KPA44097) është kryer më 19 qershor 2008 dhe e pasqyron pronën e kërkuar si pyll i pa uzurpuar dhe livadh, ndërkaq njoftimet fizike të kërkesave (KPA08233, KPA08229, KPA08227, KPA08226, dhe KPA08225), janë kryer më 29 tetor 2007, 5 shtator, 30 nëntor 2008 dhe 3 shkurt 2010. Pronat e kërkuara u gjetën të pa uzurpuara.
6. Sipas raporteve të verifikimeve, të datës 16 prill 2008; (lënda KPA44097), Fleta Poseduese nr.51 dhe Certifikata e martesës nr. 202-2-44 janë verifikuar pozitivisht, ndërsa raportet e verifikimit të vitit 2008 (KPA08225, KPA08226, KPA08227, KPA08229, KPA08233) tregojnë se janë

verifikuar pozitivisht Fleta Poseduese nr.50, Certifikata e vdekjes e 21 shkurtit 2008 dhe Vendimi i trashëgimisë O.Br.374/05.

7. Më 28 gusht 2008, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës aprovoi kërkesën (KPA44097) në vendimet e vërtetuara KPCC/D/A/22/2008. Në paragrafin 13 të vendimit, KPCC/D/A/22/2008 që zbatohet posaçërisht për kërkesën, thuhet se konfirmohet e drejta pronësore në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Më 19 dhjetor 2008, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës i aprovoi edhe kërkesat (KPA08233, KPA08229, KPA08227, dhe KPA08226) në vendimin e vërtetuar KPCC/D/A/29/2008, po ashtu edhe kërkesën (KPA08225) në vendimin e vërtetuar KPCC/D/A/76/2010 të datës 16 qershor 2010. Në paragrafin 15 të Vendimit, KPCC/D/A/22/2008 që zbatohet posaçërisht për kërkesat (KPA08233, KPA08229, KPA08227 dhe KPA08226) si dhe në paragrafin 14 të vendimit KPCC/D/A/76/2010 që zbatohet posaçërisht për kërkesën KPA08225, thuhet se paraqitësi i kërkesës apo bartësi i tanishëm i së drejtës pronësore ka trashëguar të gjitha të drejtat që i përkasin pronarit, përfshirë të drejtën për të ushtruar kërkesë për vërtetim të pronësisë dhe për ri-posedim në procedurën e tanishme; prandaj, kërkesat duhet të aprovohen.
8. Me Vendimin nr. KPCC/RES/16/2010, të datës 24 shkurt 2010, KKPK-ja është informuar nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së se kërkesat (KPA44097, KPA08233, KPA08229, KPA08227, dhe KPA08226) nuk janë proceduar si duhet nga Sekretaria apo më konkretisht pronat e kërkuara nuk janë identifikuar si duhet dhe se Komisioni nuk ishte i informuar për këtë fakt. Kërkesat janë kthyer prapa në Sekretarinë Ekzekutive të AKP-së për ri procedim të mëtejme duke e bërë identifikimin e saktë të pronës.
9. Më 24 shtator 2010; AKP-ja edhe njëherë identifikoi pronën e kërkuar (KPA44097) duke e publikuar në Gazetën e Njoftimeve nr.9. Gazeta është lënë te prijësi i fshatit i cili pranoi që t'ua lë në dispozicion atë palëve të interesuara si dhe në hyrje dhe dalje të fshatit Kotor. Publikimet e njëjta po ashtu janë lënë në Komunën dhe Kadastrin e Skenderajt, Gjykatën Komunale të Skenderajt, zyrën rajonale të AKP-së në Mitrovicë, si dhe në zyrat e OSBE-së, UNHCR-së, Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Ombudspersonit. Më 1 korrik 2010, AKP-ja i identifikoi për së dyti pronat e kërkuara (KPA08233, KPA08229, KPA08227, KPA08226, KPA08225) duke i publikuar në Gazetën e Njoftimeve nr.3. Gazeta është lënë te prijësi i fshatit i cili pranoi që t'ua lë në dispozicion atë palëve të interesuara si dhe në hyrje dhe dalje të fshatit Kotor. Publikimet e njëjta po ashtu janë lënë në Komunën dhe Kadastrin e Skenderajt, Gjykatën Komunale të Skenderajt, zyrën rajonale të AKP-së në Mitrovicë, si dhe në zyret e OSBE-së, UNHCR-së, Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Ombudspersonit.

10. Asnjë palë nuk ka shprehur interesim për të marrë pjesë në procedurë (për sa i përket pronave që janë objekt i kërkesës); brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, në përputhje me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079, prandaj, kërkesat përsëri janë konsideruar të pakontestuara.
11. Me vendimin e saj të datës 7 shtator 2011 (KPCC/D/A/119/2011), Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës konstatoi se paraqitësja e kërkesës1 kishte dëshmuar se babai i saj i ndjerë R. M. ka qenë pronari i pronës së kërkuar dhe prandaj paraqitësja e kërkesës1 kishte të drejtën e posedimit mbi pronën e kërkuar (KPA44097). Më 26 tetor 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës i aprovoi kërkesat KPA08233, KPA08229, KPA08227, KPA08226, dhe KPA08225 me vendimin e vet KPCC/D/A/126/2011. Në paragrafin 15 të vendimit, KPCC/D/A/126/2011 që zbatohet veçanërisht për kërkesat KPA08233, KPA08229, KPA08227 dhe KPA08226, thuhet se paraqitësi i kërkesës2 konsiderohet se i ka trashëguar të gjitha të drejtat që i përkasin pronarit, përfshirë të drejtën për të ushtruar kërkesë për vërtetim të pronësisë dhe për ri-posedim në procedurën e tanishme; prandaj, kërkesat duhet të aprovohen.
12. Nga provat në shkresat e lëndës (KPA08233 faqe nr. 027-037 dhe KPA44097 faqe nr. 025) vërtetohet se M. H. i është drejtuar AKP-së (me e-mail) në nëntor 2011 duke kërkuar informata të hollësishme lidhur me statusin e pronave të kërkuara të regjistruara në Fletën Poseduese 49, Fletën Poseduese nr.50 dhe Fletën Poseduese nr.51 si palë e interesuar. Përveç kësaj, M. H. në AKP dorëzoi një deklaratë të shkruar të vëllait të tij D. H. cili pretendoi se pronat e kërkuara ishin blerë nga babai i tyre B. H. gjatë vitit 1970.
13. AKP-ja, përmes shkresës Ref.01331/11/fk të datës 9 dhjetor 2011, e informoi M. H. (me email të dërguar atij me 13 dhjetor 2011 sikurse ishte kërkuar prej tij) rreth të gjitha informatave të nevojshme për ngastrën kadastrale dhe statusin e secilës kërkesë që paraqitet para AKP-së. AKP-ja e informoi M. H. se ai mund të ushtrojë ankesë para Kolegjit të Apelit të AKP-së në Gjykatën Supreme lidhur me kërkesat në lidhje me ngastrat kadastrale mbi te cilat ai pretendon te drejten ligjore që tashmë janë vendosur. Ai shprehimisht është informuar se ankesa duhet të paraqitet brenda sa me shpejte qe te jete e mundur.
14. Më 7 shkurt 2012, vendimi KPCC/D/A/119/2011 iu dorëzua S. M. Më 14 shkurt 2011, vendimi KPCC/D/A/76/2010 iu dorëzua D. M. ndërsa vendimi KPCC/D/A/126/2011 iu dorëzua D. M. më 16 mars 2012.
15. M. H. ka ushtruar ankesë para Kolegjit të Apelit të AKP-ës të Gjykatës Supreme të Kosovës me 8 Mars 2013.
16. Ankesa i është dorëzuar Paraqitësit të kërkesës 1 (në tekstin e mëtejme gjithashtu: Pala përgjegjëse në ankesë 1) me datë 12 prill 2013. Ajo është përgjigjur në ankesë me 24 mars 2013.
17. Ankesa i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës 2 me 17 korrik 2013 por ai nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Pretendimet e palës ankuese

18. Pala ankuese deklaron se vendimet e KKPK-së ishin të bazuara në shkeljen e të drejtës materiale dhe procedurale, si dhe në vërtetimin e gabuar dhe të mangët të gjendjes faktike.
19. Pala ankuese pretendon se babai i tij i kishte blerë pronat e kërkuara në vitin 1977 dhe që nga atëherë familja H. ka pasur posedim të pandërprerë mbi pronat; prandaj, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që t'i rishqyrtojë vendimet e AKP-së dhe t'i hedhë kërkesat poshtë.
20. Për më tepër, pala ankuese pretendon se familja H. ishte informuar rreth kërkesave para AKP-së më 9 shkurt 2011 përmes kërkesës KPA44101. Sipas palës ankuese, ata e kanë pranuar vendimin e KKPK-së më 26 shkurt 2013.
21. Pala ankuese gjithashtu ka paraqitur:
 - Deklaratë të shkruar të datës 11 mars 2013. Sipas deklaratës, vëllai i palës ankuese, D. H. deklaroi se ai ka qenë i pranishëm kur ishte lidhur Kontrata e Blerjes ndërmjet B. H. si blerës dhe S. M. si shitës i pronës së kërkuar. Kontrata ishte lidhur para Gjykatës Komonale të Skenderajt kah fundi i vitit 1974. Çmimi i blerjes ishte 13.000.000 dinarë (monedhë Serbe) dhe prona që ishte blerë ishte shënuar në Fletën Poseduese nr.49 me sipërfaqe totale prej 05.15.74 ha. Pagesa ishte bërë në këste gjatë vitit 1975. Në vitin 1976 shitësi ia kishte dorëzuar pronën blerësit ndërsa ai ishte transferuar në fshatin Kerligate. Kontrata e blerjes mund të gjendet në Gjykatën Komonale të Skenderajt.
Kontrata e Blerjes e lidhur ndërmjet B. M. (si shitës) dhe B. H. (si blerës). Kontrata është lidhur në vitin 1977 dhe shuma e paguar e parave ishte 13.000.000 Dinarë. Ngastrat kadastrale që janë blerë janë si në vijim: ngastra numer 126, 127,128,129,137,138,207, 208, dhe 503 me sipërfaqe totale prej 05.11.00 ha.
 - Kontrata e shitblerjes e lidhur ndërmjet R. M. (si shitës) dhe B. H. (si blerës) tregon se prona ishte blerë gjatë vitit 1977 nga R. M. Çmimi i blerjes ishte kontraktuar që të jetë 4 500.000 Dinarë. Sipërfaqja totale e pronës që ishte blerë ka qenë 02.06.71 ha. Ngastrat kadastrale që ishin blerë ishin shënuar në Fletën Poseduese nr.51 dhe ato janë si në vijim: ngastrat me numër 123, 130,133,134,135,136,139,140,500,501. Shuma prej 2.000.000 Dinarë ishte paguar ndërsa pjesa tjetër prej 2.500.000 nuk ishte paguar për shkak të kontestit lidhur me ngastrën kadastrale 134 ndërmjet R. M. dhe Rr. H. Megjithatë, D. H. tregoi vullnetin për ta paguar shumën e mbetur të çmimit të blerjes.
22. Në përgjigjen e saj, pala përgjegjëse në ankesë 1 deklaroi se ajo është e vetëdijshme për çështjen e negociimeve për blerjen por babai i saj i ndjerë nuk kishte dashur që ta shes pronën sepse çmimi i

blerjes ishte më i ulët se çmimi i tregut. Ajo shprehu vullnetin që me anë të marrëveshjes të zgjidhet kontesti ndërmjet M. H. si trashëgimtar ligjor i babait të tij dhe saj si trashëgimtare ligjore të babait të saj. Sipas palës përgjegjëse në ankesë, H. nuk kishte mohuar se babai i tij ka paguar 2 000 000.00 Dinarë (monedhë Serbe) të shumës prej 4 500 000.00 të çmimit të blerjes. Ajo kërkon nga ai që ta paguajë shumën e mbetur. Përndryshe ajo kërkon që ankesa e palës ankuese të refuzohet si pa afatshme, pasi që pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurën e shkallës së parë.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

23. Ankesa është e papranueshme.
24. Në bazë të nenit 12.1, në lidhje me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave Lidhur me Pronën e Paluajtshme, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03 / L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji nr. 03 / L-079), (vetëm) një palë mund të paraqesë ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e njoftimit të palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës lidhur me vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës.
25. Për këtë rregull ekziston një përjashtim: kur një person i interesuar nuk është i njoftuar (mirë) nga AKP-ja për kërkesën dhe nuk mundet që në mënyrë të arsyeshme të jetë në dijeni lidhur me kërkesën, ai / ajo ende mund të ankohet pasi që vendimi është marrë nga KKPK-ja, por atëherë ai / ajo duhet që të ankohet brenda 30 ditëve pasi që ai / ajo të njohtohet për vendimin e KKPK-së lidhur me kërkesën. Ankesa e paraqitur në një fazë të mëvonshme mund të konsiderohet vetëm si e pranueshme kur ky person i interesuar ka një justifikim legjitim për vonesë të mëtejshme.
26. Ankuesi nuk ka qenë palë në procedurat para KKPK-së.
27. AKP-ja e ka informuar ankuesin për vendimin grupor të KKPK-së më 13 dhjetor 2011 me anë të postës elektronike siç kishte kërkuar ai, të përmendur këtu në paragrafin 13, dhe në atë e-mail AKP-ja e ka informuar atë që të kundërshtojë vendimet e KKPK-së sa më shpejt që të jetë e mundur.
28. Ankuesi mohon në ankesën e tij se ai ka pranuar email me 13 dhjetor 2011, por Gjykata Supreme nuk bindet me këtë mohim, sepse ankuesi vet kishte përdorur korrespondencën me anë të e-mailit nga e njëjta adresë të cilën AKP-ja e kishte përdorur për t'i dërguar atij mesazh me 13

dhjetor 2011. Nuk është e mundshme që ky mesazh të mos i ketë shkuar ankuesit. Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se e-maili ishte dërguar më 13 dhjetor 2011 edhe në e-mail adresën e avokatit. Ankuesi ia ka përmendur atë adresë AKP-së në komunikimet e tij me email në vitin 2011 dhe gjithashtu e ka shtuar edhe informacionin në lidhje me të njëjtin avokat në ankesën e tij në mars 2013.

29. Ankuesi paraqiti ankesën më 8 mars 2013, më shumë se 13 muaj pas afatit prej 30 ditëve për ankesë që ka filluar për të nga data 13 dhjetor 2011. Ai nuk paraqiti asnjë justifikim legjitim për këtë vonesë.

30. Prandaj, ankesa refuzohet siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 13.3 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03 / L-079 dhe neneve 196 dhe 195/1 (a) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Mjeti juridik

31. Në bazë të nenit 13.6 të Ligjit 03 / L-079, ky vendim është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve juridike të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Rolandus Bruin , Gjyqtar i EULEX-it

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it